



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr.32, Datë 21.02.2020

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “REJ ENERGY” SH.P.K., PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS  
ME NR. 177, SERIA PV12K, PËR “PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE” NGA HEC-  
ET “CERMENICA 1”, “CERMENICA 2” DHE “CERMENICA 3”, ME FUQI TOTALE TË  
INSTALUAR 3,88 MW, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 120  
DATË 29.08.2012**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma” a”, dhe 43 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a” dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 21.02.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, me nr.30/2 Prot, datë, 07.02.2020, Mbi kërkesën e shoqërisë Rej Energy” sh.p.k për modifikimin e licencës me nr. 177, Seria PV12K, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr 120, datë 29,08,2012 për liçensimin e shoqërisë “Rej energy” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Cermenica 1”; “Cermenica 2” dhe “Cermenica 3”.

**Konstatoi se:**

- Me vendimin Nr. 29, datë 30.01.2018, Bordi i ERE filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike me nr. 177, Seria PV12K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 120, datë 29.08.2012.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 115/2 Prot., datë 02.02.2018, ka përcjellë pranë subjektit kërkesën për plotësim dokumentacioni i cili konsistonte në Miratimin e Autoritetit Kontraktues të projektit për modifikimin e licencës për rritjen e fuqisë së instaluar të HEC-eve “Cermenica 1”; “Cermenica 2” dhe “Cermenica 3”.
- Në vijim shoqëria “Rej Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 115/8, datë 29.03.2018, ka përcjellë kërkesën për shtyrje të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE duke bërë me dije se është në fazën e përgatitjes dhe dorëzimit të dokumentacionit në Institucionet përgjegjëse duke kërkuar shtyrje të afatit të Vendimmarrjes përfundimtare.

- Në mbledhjen e datës 06.04.2018, Bordi i ERE-s e pranoi këtë kërkesë duke e shtyrë afatin e vendimmarrjes finale.
- Shoqëria “Rej Energy“ sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, pika 1 të Kontratës Koncesionare, nr. 2519 Rep., 288 Kol, datë 14.07.2009, datë 14.07.2009, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k. me cilësinë e Koncesionarit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës me cilësinë e Autoritetit Kontraktues, “Për ndërtimin e Hidrocentraleve “Cermenica 1”, “Cermenica 2” dhe “Cermenica 3”, në zbatim të VKM – së nr. 194, datë 19.02.2009, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin sipas informacionit të subjektit, gjatë fazës së ndërtimit të Hec-ve ”Cermenica 1, 2, 3.
- Me shkresën nr. 6 Prot, datë 30.01.2018 shoqëria “Rej Energy” sh.p.k., i është drejtuar Autoritetit Kontraktues (MIE) duke i bërë me dije se: parametrat hidroenergjitikë janë përmirësuar si rezultat i optimizimit të pellgut ujëmbledhës të përroit të Cermenicës, ku fuqia e instaluar arrin në 14980 kW.
- Ministria e Infratrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 1944/1 Prot, datë 23.02.2018, dërguar shoqërisë dhe për dijeni ERE-s dhe AKBN-së, ndër të tjera shprehet se: Institucionet e specializuara, në të gjitha rastet duhet të informohen dhe të bëjnë vlerësimin teknik të skemës hidroenergjitike të përmirësuar.
- ERE me shkresën e saj nr. 115/7 Prot, datë 08.03.2018, ka bërë me dije shoqërinë se shkresa e MIE nr. 124/1 Prot, datë 18.10.2013 drejtuar ERE-s referon: “Në rastin kur kërkesa për rritjen e fuqisë së instaluar, vjen si shkak dhe përputhet me fuqinë e instaluar të miratuar nga Autoriteti Kontraktues, në projektin e zbatimit, atëherë nuk ka nevojë për miratimin paraprak nga Autoriteti Kontraktues, ndërsa për të gjithë rastet e tjera duhet të merret miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktues.
- Gjithashtu ERE ka dërguar edhe dy shkresa pranë MIE (shkresa me nr. 371 Prot, datë 27.05.2019 dhe shkresa me nr. 371/1 Prot, datë 25.11.2019), “Kërkesë për informacion” në lidhje me marrëveshjet e koncesionit dhe ato jo koncesionare që MIE në rolin e Autoritetit Kontraktor ka nënshkruar me shoqëritë, të cilat mund të konsistojnë në ndryshimin e kapacitetit të instaluar, afatin e ndërtimit dhe ndryshimin e aksionerëve etj., por për të cilat nuk ka marrë ende asnjë përgjigje nga MIE.
- Aplikimi i shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Neni 15, pika 4, gërma a: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës : Plotësuar.
  - Neni 15, pika 4, gërma b: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence : Plotësuar.
  - Neni 15, pika 4, gërma c: Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera : Pa plotësuar. Pas përfundimit të afatit të kërkesës për plotësim dokumentacioni dhe pas një korrespondence të gjatë, nga ana e subjektit nuk është depozituar Miratimi i modifikimit të projektit të rritjes së fuqisë nga Autoritetit Kontraktues.
  - Neni 15, pika 4, gërma d: Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licensuarit sipas legjislacionit në fuqi : Plotësuar. Modifikimi do të ketë një ndikim

pozitiv përsa i përket qëndrueshmërisë së sistemit dhe funizimit me energji elektrike të konsumatorëve.

- Neni 15, pika 4, gërma e: Të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE. Plotësuar.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Rej Energy” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e nevojshme për të miratuar kërkesën.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., për modifikimin e licencës me Nr. 177, Seria PV12K, për “Prodhimin e Energjisë Elektrike” nga Hec-et “Cermenica 1”, “Cermenica 2” dhe “Cermenica 3”, me fuqi totale të instaluar 3,88 MW, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 120, datë 29.08.2012.

2. Drejtorja e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin, Furnizuesin e Shërbimit Universal dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**